

AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE



NEWSLETTER

Gusht, 2018.

Nr. 08/2018

Referendumi, temë e takimit me përfaqësuesit e OSBE/ODIHR



Delegacioni i OSBE/ODIHR, i udhëhequr nga këshilltari i lartë për zgjedhje, Stiven Martin, sot në selinë e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale u takuan me Kryetarin e Agjencisë, Lazo Petrushevski dhe përfaqësuesit e shërbimit profesional, ku biseduan për mbulimin mediatik dhe aktivitetet e Agjencisë në lidhje me referendumin e planifikuar.

Përfaqësuesit e Agjencisë informuan se duke marrë parasysh se me Ligjin për referendum dhe format e tjera të prononcimit direkt të qytetarëve nuk ka rregulla të sakta për mënyrën e informimit të mediumeve dhe emetimit të propagandës publike, në këtë periudhë.

Në aspekt të qartësimit të KSHZ-së lidhur me mediumet dhe prezantimin mediatik, Agjencia përsëriti qëndrimin e vet se ndaj të gjitha palëve të interesuara duhet të sigurohen kushte të njëjta për qasje në propagandë publike, me çmime të njëjta për të gjithë.

Deklaratë në lidhje me propagandën publike për referendumin

Në lidhje me dilemat që u paraqitën këto ditë te radiodifuzerët lidhur me mënyrën e emetimit të propagandës së paguar publike për referendumin, ju rikujtojmë se deri më datë 17 gusht 2018 do të zgjasë debati publik në lidhje me Rekomandimet e Agjencisë për prezantimin mediatik gjatë referendunit.



Duke marrë parasysh se propaganda publike ka filluar, potencojmë se në ndërkohë, radiodifuzerët duhet të respektojnë dispozitat e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, respektivisht propagandën e paguar publike ta emetojnë në kuadër të limitit për reklamim prej 12 orëve për çdo orë reale, të ndarë qartazi nga përmbajtjet tjera dhe me porositës të shënuar. Gjatë kësaj, të gjithë subjekteve të interesuar duhet t'u sigurohen kushte të barabarta për qasje deri te koha e reklamimit, me çmime të njëjta për të gjithë.

Për këtë qëndrim, Agjencia e njoftoi edhe Komisionin shtetëror zgjedhor me shkrim si dhe në takimin e përbashkët, me rastin e prononcimit të KSHZ-së për mediumet dhe prezantimin mediatik më datë 3 gusht 2018. Agjencia potencoi se ajo që Ligji për referendum, konstaton se propozuesi i autorizuar, në këtë rast Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, mund të bëjë propagandë publike, nuk nënkupton se ka "qasje të privilegjuar" deri te mediumet, as në aspekt të shfrytëzimit të kohës e as në aspekt të çmimeve për reklamim.

Agjencia miratoi Udhëzuesin për prezantim mediatik gjatë referendunit

Këshilli i Agjencisë në mbledhjen e 34-të, nga data 17.08.2018 e miratoi Udhëzuesin për prezantim mediatik gjatë referendunit.

Në këtë dokument janë të shënuara rregullat për radiodifuzerët komercial dhe për shërbimin publik të radiodifuzionit, në lidhje me mënyrën e raportimit dhe prezantimit mediatik në emisionet e informimit ditor, programet e vecanta informuese dhe programet e tjera, rregullat për shpalljen e rezultateve të hulumtimit të mendimit publik, propagandës së paguar publike, informimit gjatë ditës së heshtjes së referendunit.



AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE



NEWSLETTER

Debati publik lidhur me Draftin e Metodologjisë për monitorimin e prezantimit mediatik zgjedhor përmes shërbimeve programore të radios dhe televizionit gjatë proceseve zgjedhore

Agjencia më 24 gusht hapi debat publik lidhur me tekstin e Draft-Metodologjisë për monitorimin e prezantimit mediatik zgjedhor përmes shërbimeve programore të radios dhe televizionit gjatë proceseve zgjedhore.

Nevoja për këtë dokument doli nga ndryshimet në Kodin Zgjedhor në lidhje me prezantimin zgjedhor mediatik si dhe kompetencat e Agjencisë dhe me të saktësohet mënyra se si Agjencia e kryen monitorimin.

Agjencia i fton të gjitha palët e interesuara që me mendimet dhe propozimet e tyre të marrin pjesë në debatin publik dhe të njëjtat t'i dorëzojnë në formë të shkruar, në adresën elektronike contact@avmu.mk, deri më datë 22 shtator 2018.

Përpilohet studimi për kornizën rregulluese të medieve dhe medimeve online

Për nevojat e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, me ndihmë të ekspertëve të Këshillit të Evropës është përpiluar studimi "Korniza rregulluese e medimeve dhe medimeve online – rasti i Maqedonisë". Në të është bërë një analizë krahasuese e legjislaturës së vendeve anëtare të Bashkimit Evropian në aspekt të medimeve online, definimi i tyre, rregullimi dhe jepen rekomandime për ndryshimet dhe plotësimet e mundshme të kornizës ligjore.


Analiza tregon se në vendet anëtare të BE-së, shtrirja materiale e kornizës rregulluese për medime është e kufizuar në shërbimet mediatike audiovizuale, siç është e definuar me Direktivën e ASHMA, për çka edhe nuk përfshihen medimet online që kryesisht nuk janë audiovizuale. Megjithatë, në disa vende, siç theksohet edhe në studim, mund të gjenden definicione për medimet online (ose medimet elektronike dhe konceptet e ngjashme), ose në Ligjin për shërbime audiovizuale, ose më shpesh, në ligje konkrete për medime.

Studimi mund të merret në www.avmu.mk gjuhën maqedonase dhe angleze, ndërsa së shpejti do të përkthehet edhe në gjuhën shqipe.

Analiza e strukturës së të punësuarve në industrinë mediatike audio dhe audiovizuale në vitin 2017

Agjencia në muajin gusht e prezantoi analizën e strukturës së të punësuarve në industrinë mediatike audio dhe audiovizuale në vitin 2017, ku janë prezantuar të dhënat për numrin dhe strukturën e përgjithshme në industrinë mediatike audio dhe audiovizuale gjatë vitit 2017, që nuk janë siguruar nga vetë radiodifuzerët.

Analiza është bërë nga aspekti i strukturës së të punësuarve sipas vendeve të punës ku janë angazhuar (gazetarë, redaktorë, drejtues, kuadër teknik, kuadër realizues, marketing dhe kuadro tjera), statusi (marrëdhënie e rregullt pune ose angazhim me honorar), gjininë, arsimin, si dhe përkatësinë etnike.



AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE



NEWSLETTER

Mbikëqyrjet ndaj radiodifuzerët, mediumet e shtypit dhe RRPKE

Radiodifuzerët

Agjencia realizoi mbikëqyrje të rregullt programore ndaj TV Kanal 8, TV Koçani LD, TV Svet dhe TV Zdravkin, në lidhje me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me obligimet për mbrojtjen e personave të mitur, rregullat për emetimin e komunikimeve komerciale, obligimet gjatë sigurimit të kuizeve ose formave tjera të pjesëmarrjes shpërblyese, shfrytëzimin e shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar, si dhe votim telefonik dhe emetimin e lojrave të fatit

Mbikëqyrja tregoi se në programin e TV Zdravkin nga Velesi, më 4 korrik 2018 janë emetuar disa programe artistike pa shënuar sinjalizimin për mbrojtjen e personave të mitur, ndërsa filmi kinematografik "Venera dhe Vegas" (Venus & Vegas) është emetuar në periudhë joadekuate të ditës. Për këtë shkelje radiodifuzerit i është shqiptuar masa e vërejtjes

Ndaj këtyre televizioneve është realizuar edhe mbikëqyrje administrative në lidhje me obligimet për publikimin e impresumit, informatave që duhet të jenë në dispozicion të shfrytëzuesve dhe për identifikimin e radiodifuzerit. Mosrespektimi i obligimit për shpalljen e impresumit është konstatuar edhe te TV Kanal 8, ndërsa te TV Svet, TV Koçani LD dhe TV Zdravkin, mosrespektimi të obligimeve për shpalljen e informatave që duhet të jenë në dispozicion të shfrytëzuesve. Për këto shkelje radiodifuzerëve u janë shqiptuar masa e vërejtjes

Në lidhje me respektimin e Rregullorës për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për emetim të radios dhe televizionit, është realizuar mbikëqyrje e jashtëzakonshme administrativë ndaj TV Nova – në falimentim, ku u konstatua se televizioni nuk i plotëson kushtet minimale teknike të përcaktuara me këtë Rregullore. TV Nova – në falimentim më 15 gusht 2018, e njoftoi Agjencinë se të gjithë të punësuarit që janë hasur deri në ditën e hapjes së procedurës falimentuese, janë ç'lajmëruar nga drejtori i falimentimit në TV Nova, televizioni nuk ka të punësuar, por me hapjen e procedurës falimentuese për envojat e procedurës nga ana e drejtorit të falimentimit janë angazhuar dy persona

Për shkak të mosplotësimit të kushteve të përcaktuara kadrovike sipas Rregulloreës për kushtet miniamel për marrjen e lejes për emetim të radios dhe televizionit, Këshilli i Agjencisë gjatë mbledhjes së 37-të të mbajtur më 30 gusht 2018, i hoqi lejen e emetimit të TV Nova-në falimentim.


Mbikëqyrje e realizuar kontrolluese ndaj radio BI KI AL nga Manastiri, ku Agjencia konstatoi se janë plotësuar kushtet minimale kadrovike për punë, të përcaktuara sipas Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për emetim të radios dhe televizionit. Radio BI KI AL dorëzoi deri te Agjencia dokumentacionin me të cilin dëshmohej se në radiostacion janë të punësuar tre persona, prej të cilëve dy me përgatitje të lartë profesionale, të angazhuar si gazetarë.

Mediumet e shtypit

Ndaj shoqërisë për prodhim, shërbime dhe tregti ZAMAN SHPKNJ Shkup, botues i gazetës së përvjetshme Zaman, u krye një mbikëqyrje administrative kontrolluese për të përcaktuar nëse ishte vepruar sipas masës së shqiptuar të vërejtjes, së shqiptuar për mos publikimin e të dhënave për numrin e kopjeve të shtypura në botimin nr. 1155, e cila mbulon periudhën prej 28 gushtit deri më 3 shtator 2018. Mbikëqyrja tregoi se është vepruar në tërësi sipas masës së ndërmarrë të vërejtjes, repsektivisht se është përmirësuar shkelja e nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit për Medime.

RRPKE

Agjencia realizoi një mbikëqyrje të rregullt programore ndaj operatorëve Kabel, Kabel-Net, Inel Internacional, Multimedia-Net, Robi dhe Transhpedit Trejd, në lidhje me obligimet për regjistrimin e shërbimeve programore në Agjenci, si dhe për titrimin e programeve që i rritransmetojnë operatorët kabllor. Mbikëqyrja ndaj Kabel-Net nga Strumica tregoi se shërbimet programore Fight Box, Film Box, Film Box Extra, Film Box Arthouse dhe Docu Box që i ka rritransmetuar operatori, nuk janë të përfshira me vërtetimet për regjistrim të shërbimeve programore të lëshuar nga Agjencia, që është në kundërshtim me nenin 141 nga LSHMAA. Te operatorët tjerë nuk janë konstatuar shkelje.



AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
rr. Maqedonia nr. 38, 1000 Shkup
Tel. (02) 3103400 faks: (02) 3103401

e-posta: contact@avmu.mk ueb faqia: www.avmu.mk

